

Kreu > Kronikë > “Silenciatori” çon në pranga tre persona, do shisin armë dhe antiplumb si...

Kronikë Lajme

“Silenciatori” çon në pranga tre persona, do shisin armë dhe antiplumb si të po euro

15:38 / 25 Gusht, 2020 0

Like 6

Facebook Twitter LinkedIn Telegram Email Print



Policia ka arrestuar 3 persona për vjedhje në Durrës pasi në automjet iu gjet armë dhe antiplumb si të uniformave blu që do i shisin për 3 mijë euro.

Njërit prej të arrestuarve iu gjetën dhe 10 doza drogë në banesë, kurse automjeti ishte tip “BMW” dhe Policia kishte marrë informata më parë duke e rrujtur nën vëzhgim.

Ndërkohë operacioni i koduar “Silenciatori” vijon edhe për personat që do i blinin armën dhe antiplumbin.

NJOFTIMI NGA POLICIA

Durrës

Finalizohet me sukses operacioni i koduar “Silenciatori”.

Operacioni nga Seksioni për Hetimin e Narkotikëve në bashkëpunim të ngushtë me nga Forca e Posaçme Operacionale në DVP Durrës.

Sekuestrohen armë zjarri me silenciator, drogë e veshje antiplumb si të Policisë.

Vihen në pranga 3 shtetas, 1 prej tyre i dënuar më parë për veprën penale të vjedhjes.

Në vijim të punës për parandalimin, evidentimin dhe goditjen e personave që qarkullojnë me armë zjarri apo me lëndë narkotike, falë edhe kontrolleve të shtuara kohët e fundit me qëllim rritjen e parametrave të sigurisë, bazuar në informacionet që Seksioni për Hetimin e Narkotikëve dispononte, në bashkëpunim me Forcat e Posaçme Operacionale, është organizuar dhe finalizuar operacioni policor i koduar “Silenciatori”, në kuadër të të cilit u arrestuan në flagrancë shtetasit:

M., 28 vjeç; V. Z., 24 vjeç dhe E. K., 32 vjeç, i dënuar më parë për veprën penale “Vjedhja”, të tre banues në Durrës.

Mbi bazën e informacioneve të marra më parë, është mbajtur nën vëzhgim mjeti me të cilin këta shtetas po qarkullonin dhe në lagjen nr.17, Kënetë, Durrës, shërbimet e Policisë kanë ndaluar mjetin e dyshuar për kontroll.

Gjatë kontrollit të ushtruar në mjetin tip “BMË”, me drejtues shtetasin B. M., në sediljen e pasagjerit, në një çantë dore, shërbimet e Policisë kanë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale një armë zjarri me silenciator dhe në bagazhin e mjetit një jelek antiblumb si i Policisë.

Nga hetimet dhe informacionet e marra, rezulton se armën e zjarrit dhe antiplumbin do t'i shisin kundrejt vlerës 3000 euro.

Gjatë kontrollit fizik dhe në banesën e shtetasit V. Z., u gjetën 10 doza me lëndë narkotike të dyshuar Cannabis Sativa.

Në bashkëpunim me Prokurorinë, vijon operacioni për identifikimin dhe kapjen e personave që do të blinin sendet e kundërligjshme.

Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Durrës për veprat penale “Armëmbatja pa leje” dhe “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”.

f t in Telegram Email Print

Artikulli paraparak

Kosovë/ 136 persona të prekur me COVID-19, humbin jetën tetë pacientë në 24 orët e fundit

Artikulli tjetër

Yuri Kim ndalet në Dhërmi për kafe e raki: Zonjat duken serioze në foto, por ishin gallatë...

ARTIKUJ TË NGJASHËM MË SHUMË NGA AUTORI

Aksident në rrethana të paqarta në Himarë, plagoset një qytetar

Parakalimi i gabuar dhe celulari në timon shkeljet “e preferuara” të shoferëve shqiptarë! Brenda ditës 563 gjoba

Arrestohet drejtori i Tatimeve Korçë, reagon DPT: Përsëritësishëm operacionin dhe mbështesim policinë

< >

PËRGJIGJU

Koment:

Emri.*

Email.*

Webfaqja:

☐ Më ruaj emrin, email dhe website në këtë browser kur të komentoj herës tjetër.

Posto Komentin

POSTIMET MË TË POPULLUARA

Letra prekëse: Thuaj motrës time që të mos trembet, mami, thuaj babit që të jetë...

23:16 / 5 Shkurt, 2019

Tragjike në Berat/ Po hapnin pus për vaditje dhe mbetën të bllokuar, tre personat humbin...

09:51 / 7 Maj, 2020

Tërmeti në Kobe që la të vdekur 6.434 njerëz, vuri standardet botërore të ndërtimit anti-tërmet

23:55 / 30 Nëntor, 2019

KATEGORI E POPULLARIZUAR

Lajmet e Fundit	50758
Kryesora	20267
Lajme	16394
Politikë	11543
Kronikë	11488
ShowBiz	9939
Rajon&Dota	6091
Lifestyle	5799
Sporti	2987

Tirananevsn vjen si një media e pavarur duke sjell lajme, politik, ekonomi, showbiz etj.

Na kontakto: info@tirananevsn.al

f i in t

NIPT: L91311015S